Loja siguron:

- zbulimin e kreativitetit dhe të imagjinatës së fëmijës;
- pikëpamje të reja, mundësi që të krijohen ide, aftësi dhe fjalë të reja;
- besimin, bashkëpunim dhe shprehjen e lirë;
- ndjenjën e sigurisë; dhe
- shumë kënaqësi.

Për këshilla të tjera drejtohuni në Qendrën e Mjekësisë Familjare.

Përgatitur nga: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, Qendra për Zhvillimin e Mjekësisë Familjare, Qendra për Edukim të Vazhdueshëm Infermierik, Zyra e UNICEF-it për Kosovë, Organizata Botërore e Shëndetësisë - Zyra në Prishtinë, Kryqi i Kuq i Kosovës, Miqtë e Shëndetit, Everychild dhe KEC - Qendra për Arsim e Kosovës.

Shtypja e fletëpalosjeve është realizuar nga UNICEF-i dhe financuar nga Qeveria e Luksemburgut, në kuadër të projektit të përbashkët UNFPA-UNICEF-OBSh "Partneriteti për përmirësimin e shëndetit të grave dhe fëmijëve në Kosovë" në partneritet me Ministrinë e Shëndetësisë.

design@d-line.info
Ilustrimi: J.Mikullovci

PARENTING INITIATIVE - PRINDËSIA E MIRË - BETTER

prindësia e mirë

Fëmija mëson duke luajtur dhe luan duke mësuar

LOJA

Rëndësia e lojës

Gjatë lojës fëmija mëson për vete dhe për botën që e rrethon. Çdo fëmijë meriton të luajë, kurse krijimi i mundësive për lojë është përgjegjësi prindërore.

Ajo i ndihmon fëmijës t'i zhvillojë imagjinatën, respektin për veten, sigurinë si dhe bashkëpunimin me të tjerët.

Me lodra mund të bëhen lojëra të shkëlqyeshme edukative që e ndihmojnë fëmijën të rritet dhe të mësojë.

Fëmija mund të krijojë lodra edhe nga materiale shumë të thjeshta. Ai mund të hulumtojë edhe nëse luan me rërë, gurë, enë plastike, fasule, misër, makarona....

Loja ndihmon në të gjitha fushat e zhvillimit: në aspektin emocional, fizik, shoqëror, intelektual dhe krijues.

Krijimi i mundësive të mira për lojë është një gjë e rëndësishme për një fëmijëri të shëndoshë.

Prindër, ju e keni rolin kryesor që ta ndihmoni fëmijën t'i zgjedhë lojërat e tij.

Loja i ndihmon fëmijës të jetë pjesë e shoqërisë, duke e mësuar:

- të jetë i pavarur;
- të jetë kreativ;
- të veprojë me përgjegjësi;
- të bëjë zgjedhje dhe t'i kuptojë pasojat;
- të zhvillojë aftësi të të menduarit kritik;
- t'i definojë dhe t'i shprehë nevojat e tij;
- t'i respektojë të tjerët.

Loja e aftëson fëmijën të përdorë përvojat e tij jetësore për ta kuptuar se si funksionon bota që e rrethon.

Loja zvogëlon në minimum tensionimin që shfaqet shpesh te fëmijët, kur ata duan të arrijnë apo të mësojnë diçka.

Loja është një formë aktive e zhvillimit të plotë të fëmijës.

Çka duhet bërë?

1. **Jepi** rast fëmijës që t'i zgjedhë lojën dhe mënyrën si do të luajë.
2. **Inkurajoje** fëmijën t'i zgjidhë vetë problemet. Nëse ju i kryeni veprimet e lojës, atëherë kjo lojë s'është për të.
3. **Mbaj mend** se fëmijët janë të ndryshëm: disa kanë dëshirë për lojëra elektronike, disa adhurojnë lojëra me fjalë, disa janë të lindur të aktrojnë, kurse disa pëlqejnë ndërtimin (po edhe prishjen) e gjërave të ndryshme. Andaj, mendo për aktivitetet që i do fëmija yt dhe lëre të luajë!
4. **Lejoni fëmijët** të fitojnë ndonjëherë gjatë lojërave të përbashkëta. Të mësosh të humbasësh është po ashtu aftësi sociale me rëndësi, por mundohu ta mbash disponimin e këndshëm gjatë lojës.
5. **Bashkohu** në lojën imagjinative të fëmijës! Fëmijët kanë dëshirë kur prindërit e tyre aktrojnë dhe i japin liri imagjinatës së tyre.
6. **Lejo** që fëmija të të mësojë se si të lozësh me lodrat e tij. Për të është kënaqësi kur i ndërroni rolet dhe të tregon ato që ai di.
7. **Lejoje** fëmijën të dalë jashtë për të luajtur. Është më mirë për shëndetin dhe është më argëtuese. S'prish punë nëse përlyhet ose laget... Fundja, pse i kemi banjën dhe lavatriçen?
8. **Tregoji** për lojërat që ti ke luajtur kur ishe fëmijë, si i ke përjetuar, sepse ka gjasa që edhe fëmijës t'i pëlqejnë ato.
9. **Lejoje** fëmijën që ta përjetojë lojën!

Lodrat dhe lojërat i ndihmojnë fëmijës të fitojë përvoja të reja, si dhe zhvillim të pakufizuar të aftësive të të mësuarit.